



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 14326 Prot.

Lezhë, më 30 . 07 . 2021

VENDIM

Nr. 123 Datë 29 . 07 . 2021

PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E VITIT 2021

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë,

Vendosi :

1.Miratimin e një ndryshimi në buxhetin e bashkisë për vitin 2021 si më poshtë:

1/a-Në programin buxhetor “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, të bëhet pakësimi i fondeve në shumën 1,097,585.99 lekë, respektivisht për zërin: “Shpenzime konsulencë juridike” në shumën 1,097,585.99 lekë, fondi i cili ishte 3,000,000 lekë – bëhet 1,902,414.01 lekë.

1/b-Në programin “Planifikim Urban Vendor” të bëhet shtesë fondi në shumën 1,097,585.99 lekë, fond i cili do të përdoret për zërat respektiv: a-Mbikqyrje punimesh të rindërtimit të 42 banesave individuale në shumën 979,987.49 lekë, b-Kolaudim dhe përgatitje dokumentacioni përfundimtar të rindërtimit të 42 banesave individuale në shumën 117,598.50 lekë.

Për këtë të kryhen veprimet si më poshtë:

- Gr.00, Prog.01110, Kap.05, Art.602 - pakësohet në shumën 1,097,585.99 lekë.
- Gr.00, Prog.06140, Kap.05, Art.602 - shtohet në shumën 1,097,585.99 lekë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ARNEST RAKAJ

